



THIRRJE PËR PROJEKT - PROPOZIME

MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E BIZNESIT ME FONDE PËR VITIN 2025



**AFATI
30 DITË**

Thirrja qëndron e hapur 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Për më shumë vizitoni
faqen e AIDA-s
www.aida.gov.al

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve hap thirrjen për mbështetjen dhe zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) për vitin 2025, nëpërmjet fondit “Për zhvillimin e ndërmarrjeve”, sipas përcaktimeve të nenit 11, të ligjit nr. 43/2022 “Për ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme”, i cili financohet nga buxheti i shtetit.

Kjo thirrje mbështet zhvillimin e NMVM-ve duke synuar rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin/rinovimin e teknologjisë, zhvillimin e artizanatit, si dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse, me qëllim nxitjen drejt eksportit dhe forcimin e aftësive të tyre lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm. Kjo thirrje synon mbështetjen e NMVM-ve që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të vendit.

Projekt - propozimet e paraqitura nga NMVM-të duhet t’i përmbahen kriterëve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për NMVM-të për vitin 2025.

Drejtimit e Thirrjes për mbështetjen financiare nga Programi “Mbështje për Zhvillimin e Biznesit” janë:

SKEMA 1

MBËSHËTETJE
FINANCIARE
PËR SHPENZIME
KORRENTE

SKEMA 2

MBËSHËTETJE
FINANCIARE
PËR SHPENZIME
KAPITALE

1

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR SHPENZIME KORRENTE

Vlera e financimit deri në 2,500,000 lekë
Mbulimi i kostove 100%

Kostot e mbulueshme:

- Certifikim i standardeve të prodhimit/shërbimit (përfshirë konsulencën përkatëse në fazën përgatitore);
- Përmirësim i produktit përmes etiketimit, ambalazhimit;
- Trajnime të stafit të ndërmarrjes për rritje kapacitetesh në fusha të tilla si: menaxhimi i teknologjive digjitale/inovatore, rrjetet e prokurimit, shërbime marketingu, zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës së biznesit, sisteme të reja logjistike, softwerike apo pajisje të reja, etj, dhe pajisje me certifikatat përkatëse nga subjekte të licensuara për trajnime;
- Pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare me stenda të gatshme;
- Krijim i aplikacioneve apo platformave në funksion të zhvillimit të proceseve lidhur me tregtinë elektronike (*e-commerce*), produkteve të reja dhe/ose shërbimeve, për të përmbushur kërkesat e industrisë së tregut në vend dhe rajon për të përmirësuar biznesin, sistemet logjistike, etj;
- Përgatitje e materialeve promovuese si: banera, fletëpalosje, katalogë, broshura për përmirësim të imazhit të NMVM-ve (jo më shumë se 20% e koston totale të projektit).

2

MBËSHTETJE FINANCIARE PËR SHPENZIME KAPITALE

PROJEKTE PËR KONKURRUESHMËRINË

Vlera e financimit deri në 1,500,000 lekë
Mbulimi i kostove 100%

Kostot e mbulueshme:

- Blerje e makinerive që ndikojnë në rritjen e prodhimit dhe përmirësimin e cilësisë së produktit.

PROJEKTE PËR ARTIZANATIN

Vlera e financimit deri në 1,000,000 lekë
Mbulimi i kostove 100%

Kostot e mbulueshme:

- Blerje e makinerive tradicionale dhe/ose teknologjike për të përmirësuar kushtet e punës për biznesin;
- Blerje e aplikacioneve dhe/ose programeve të e-commerce.



- Kërkuesi për mbështetje me fond dërgon kërkesën në rrugë elektronike në adresën e AIDA-s ndermarrje@aida.gov.al. Dërgimi i kërkesave në rrugë elektronike do të konfirmohet nga AIDA me një përgjigje me e-mail dhe do të protokollohen me datën e mbërritjes në adresën ndermarrje@aida.gov.al;
- Formulari i kërkesës dhe dokumentacioni i dërguar në rrugë elektronike duhet të jetë në formatin pdf;
- Thirrja qëndron e hapur 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga dita e publikimit të saj;
- Njoftimi për thirrje do të publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit www.meki.gov.al dhe në faqen zyrtare të AIDA-s www.aida.gov.al dhe në rrjetet sociale të Agjencisë;
- Formulari i kërkesës, buxhetit dhe deklarata për kategorinë e NMVM-ve do të shkarkohen në linkun që do të vihet në dispozicion nga AIDA.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM , QË DUHET TË SHOQËROJË KËRKESËN PËR APLIKIM



1. Formularin e kërkesës të plotësuar (shkarkohet nga faqja web e AIDA-s);
2. Formularin e buxhetit (shkarkohet nga faqja web e AIDA-s);
3. Certifikatën e regjistrimit në regjistrin tregtar;
4. Ekstraktin Historik të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me status aktiv;
5. Deklaratën për kategorinë e NMVM-ve, në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 5 të ligjit nr. 43/2022 (shkarkohet nga faqja web e AIDA-s);
6. Vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet tatimore, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga e-Albania;
7. Vërtetim që subjekti ka paguar të gjitha detyrimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga e-Albania;
8. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, që ka paguar detyrimet doganore në rastin kur NMVM është eksportuese, në momentin e dorëzimit të kërkesës për përfitim fondi, të shkarkuar nga e-Albania;
9. Pasqyrat financiare të vitit të fundit të ushtrimit të aktivitetit të certifikuar nga organet tatimore dhe/ose Formulari i deklarimit të të ardhurave, i shkarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
10. Dëshmi Penaliteti të administratorit të ndërmarrjes;
11. Kopje të ID-së të administratorit të NMVM-së ose prokurë përfaqësimi dhe ID e përfaqësuesit në rast se aplikuesi nuk është administratori i NMVM-së;
12. Çdo dokument tjetër shoqërues që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.



Shkarko
Dokumentacionin
e Aplikimit

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen të firmosura dhe vulosura nga aplikuesi origjinal ose kopje të njësuara me origjinalin dhe të kenë afat vlefshmërie jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit për fonde.

Dokumentacioni duhet të dorëzohet në rrugë elektronike në adresën ndermarrje@aida.gov.al i nënshkruar dhe vulosur nga aplikuesi, origjinal ose kopje e njësuar me origjinalin.



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve